



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proçes verbal

Sot me datë 13.03.2024 ora 14:00 u mbledh mbledhja e **Kryesisë së Këshillit bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e rradhës të Këshillit bashkiak.

Të pranishëm janë:

Mungon:

Z. Oltion Luli

Z.Blendi Gjylbegaj

Znj. Irena Shala

Z. Gjergj Sokoli

Z. Edmond Ndou

Znj.Valjeta Bajraktari

Znj. Violeta Perndrecaj

Vijohet me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit.

Znj.Shala në emër të grupit të Kualicionit Bashkë Fitojmë kërkon që në mbledhjen e Këshillit kërkesa për interpenca e bërë nga ana e tyre të jetë pjesë e rendit të ditës.

Z.Luli sqaron se kjo kërkesë del jashtë kornizave të asaj që kërkon ligji, pasi ristrukturimi i bërë është krejtësisht tagër i kryetarit të bashkisë.

Përsëri Znj.Shala shprehet se kërkesa e tyre për interpelancë është krejtësisht e mbështetur në ligj dhe rregullore.

Z.Luli dhe Z.Ndou sqarojnë përsëri se çështja objekt e interpelancës është tagër dhe kompetencë vetëm e kryetarit të bashkisë dhe nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 64 të ligjit 139/2015, ku janë të përcaktuara qartë çështjet për të cilat Kryetari i bashkisë raporton në Këshill.

Vijohet me diskutime mbi këtë pikë dhe duke qënë se nuk arrihet me mirëkuptim që kjo kërkesë të përfshihet në rendin e ditës, kalohet me hedhjen e saj në votim, ku rezultojnë **3** vota Kundër **2** vota Pro.

Diskutohet gjithashtu mbi pikat e tjera të parashikuara për rendit të ditës, për të cilat kryetarët e grupeve bien të gjithë dakort. Diskutohet dhe bihet në dakortësi edhe për datën e mbledhjes së ardhshme të këshillit. Caktohet dt. 20.03.2024 ora 17:00..

Rendi i ditës do jetë si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2023".
2. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2023".
3. Pr/ Vendim: "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2025-2027.
4. Pr/ Vendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Shkodër".
5. Raportim vjetor i veprimtarisë së Këshillit bashkiak për vitin 2023.

Diskutime jashtë rendit të ditës

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, mbledhja deklarohet e mbyllur.

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti

SEKRETAR


Denis Lesha